

VEPRIMTARIA E AWEN

RAPORT VJETOR

2018



FUQIA E 'NJË ZËRI'

RRJETI I FUQIZIMIT TË GRUAS NË
SHQIPËRI - AWEN

Së bashku, për gratë e vajzat

MBËSHËTETJE, MË
DHE PROMO
I TË DREJTAVE DHE INTE
TË GRAVE DHE VAJZAVE NË

PROGRAMI "MBROJTJA DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË GRAVE NË SHQIPËRI" 2016 – 2018, mbështetur nga Sida - Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Objektivi i përgjithshëm i programit: Përmirësimi i pozitës dhe situatës së grave në lidhje me të drejtat e tyre në Shqipëri, nëpërmjet mbështetjes financiare për organizatat anëtare të AWEN.

Rezultati 1. Pushteti qendror dhe ai vendor promovojnë gjithnjë e më shumë mbrojtjen e të drejtave të grave. Disa arritje kyçe janë:

- ◆ **Advokim dhe lobim i vazhdueshëm në lidhje me zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit dhe politikave aktuale për barazinë gjinore;**
- ◆ **Kontribut konkret për të përmirësuar legjislacionin dhe politikat në nivel qendror dhe vendor/ Nisma advokuese;**
- ◆ **Studim Kombëtar mbi Dhunën në Marrëdhëniet Intime (DhMI) në Adoleshencë - Gjatë vitit 2018,** ekipi i përzgjedhur i kërkuesve, në bashkëpunim të ngushtë me stafin e programit të AWEN dhe organizatat anëtare, realizoi dhe finalizoi studimin. Gjetjet e studimit po përdoren gjatë nismave ndërgjegjësuere dhe advokuese për adresimin e DhMI në adoleshencë.



- ◆ **Është mbështetur krijimi i 5 Mekanizmave të rinj Referimi kundër Dhunës në Familje në njësitë administrative Finiq, Delvinë, Konispol, Malësi e Madhe dhe Vau i Dejës.** Është themeluar Strehëza Emergjente për viktimat e dhunës në familje në Dibër (2018);

Rezultati 2. Anëtarët e AWEN janë të afta të zbatojnë projekte dhe nisma për mbrojtjen e të drejtave të grave. Disa arritje kyçe janë:

- ◆ **10 projekte të zbatuara gjatë 2018 nga organizatat anëtare – 8 projekte vjetore dhe 2 nisma advokuese emergjente (34 projekte të zbatuara me mbështetjen financiare të Sida-s gjatë 2016-2018);**
- ◆ **Kanë marrë mbështetje 1288 vajza e gra gjatë vitit 2018,** nëpërmjet: shërbimeve akomoduese 156 gra e 67 fëmijë; asistencë psikologjike për 1079 vajza e gra; asistencë/ shërbime ligjore për 550 vajza e gra; shërbime ri/integruese për 209 vajza e gra. 4433 vajza e gra janë asisitur përgjatë 2016-2018;
- ◆ **Rreth 4415 vajza e gra viktimat të dhunës në familje/me bazë gjinore kanë marrë këshillim, asistencë dhe shërbime referuese nëpërmjet telefonit nga organizatat anëtare;**
- ◆ **Janë ngritur kapacitetet e 654 përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe strukturave vendore nëpërmjet trajnimeve dhe seancave ndërgjegjësuere; 2489 përgjatë 2016-2018;**
- ◆ **Rreth 780 të rinj janë angazhuar si aktivistë/ praktikantë pranë organizatave anëtare. 1009 djem e vajza gjatë 2016-2018;**
- ◆ **Janë ndërgjegjësuar lidhur me të drejtat e grave dhe vajzave nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuere rreth 5261 persona, djem dhe burra, vajza dhe gra. 13919 përgjatë 2016-2018;**
- ◆ **Rreth 29 djem dhe burra dhunues kanë marrë shërbime rehabilituese, kryesisht këshillim psikologjik. 48 gjatë 2016-2019;**

Rezultati 3. Anëtarët e AWEN janë organizata të konsoliduara dhe të qëndrueshme, si dhe kanë kapacitete për të kontribuar në promovimin e të drejtave të grave. Disa arritje kyçe janë:

- ◆ **Zhvillim organizativ i AWEN dhe organizatave anëtare:** Krijimi dhe konsolidimi i praktikave monitoruese, politika dhe procedura funksionale dhe të përmirësuar, plane strategjike të rishikuar/ zhvilluar, trajnime në tematika të ndryshme, vizitë studimore në Suedi dhe shkëmbime eksperiencash mes organizatave anëtare dhe aktorëve vendor në disa bashki; pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare;
- ◆ **Rritja e numrit të bashkëpunëtorëve me së paku me 30% (AWEN dhe anëtarët);**
- ◆ **Rritja e numrit të grupeve të synuara dhe përfitueseve me 30%.**
- ◆ **Të paktën 1 fushë e re ekspertize është shtuar nga secila organizatë anëtare gjatë 2016-2019;**



PROJEKTE TË TJERA - 2018

Projekti: "Advokim për barazinë gjinore dhe proceset e integritit në BE", mbështetur nga **Kvinna till Kvinna**

- 40 studentë të gazetarisë u aftësuan rreth njohjes së stereotipeve gjinore në media, legjislacionit dhe protokolleve të BE-së lidhur me raportimin e ndjeshëm gjinor, gjatë një trajnimit të zhvilluar në Mars 2018;
- 360 vajza e djem nga 15 shkolla të mesme nga i gjithë vendi u bënë pjesë e aktiviteteve dhe mini-konkurseve nëpër shkolla, gjatë aktiviteteve zbatuar nga organizatat anëtare të AWEN (Nëntor-Dhjetor 2018);
- U organizuan 8 takime/tryeza të përbashkëta me partnerë lokalë e OJF me temë: BE dhe Përkatësia Gjinore;
- 6 mini projekte u organizuan nga rreth 400 të reja e të rinj të shkollave të mesme në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Pogradec dhe Sarandë me tematikë barazinë gjinore;
- AWEN ka marrë pjesë aktivisht e ka dhënë kontribut në më shumë se 30 konsultime, takime advokuese e lobuese të zhvilluara në kuadër të proceseve të integritit në BE në perspektivën e barazisë gjinore.

ShGPS, Durrës në partneritet me AWEN mbështetur nga **Fondi për Barazi Gjinore i UN Women** ka zbatuar Projektin "Rezoluta 1325: Të Drejtat e Grave – Koncepti në Realitetin botëror dhe realitetin Shqiptar"

- Lobim dhe advokaci për Hartimin dhe Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit (Rezoluta 1325)
- Aktivitete/Takime ndërjegjësuese

GADC në partneritet me **AWEN & Anëtarët** kanë zbatuar projektin: "Ndërtimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020", zbatuar me mbështetjen e **UN Women** dhe financuar nga Komisioni Evropian.

- Monitorim i zbatimit të Mekanizmave të Referimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore në 6 bashki të mëdha të vendit: Tiranë; Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër dhe Korçë;
- Publikim i raporteve monitoruese në 6 bashkitë e synuara;
- Aktivitete ndërjegjësuese e informuese në 6 bashkitë

FUSHATA NDËRGJEGJËSUESE

Mars 2018 – Muaji i Gruas & Dita Ndërkombëtare e Gruas

- **Forume me studente** rreth barazisë gjinore gjatë Muajit Ndërkombëtar të Gruas (Mars) në universitetet 'Aleksandër Xhuvani', Elbasan dhe 'Aleksandër Moisiu' Durrës, me pjesëmarrjen e Ambadorit të Suedisë, Z. Johan Ndisi.



- **Manifestim paqësor ndërgjegjësues** në Sheshin 'Skënderbej' me mbulim të gjerë mediatik, në bashkëpunim me të paktën 20 organizata të tjera të shoqërisë civile, 8 mars 2018, me tematikën 'Barazi dhe dinjitet'.



Fushatë Kombëtare 'T'I JAPIM FUND DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE'

16 Ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore: 25 Nëntor–10 Dhjetor 2018

AWEN dhe 9 organizatat anëtare hartuan një kalendar të ngjeshur me **më shumë se 66 aktivitete ndërgjegjësuese në të gjithë vendin**. Aktivitetet, të mbështetura kryesisht nga donatorë të AWEN gjatë 2018, por jo vetëm, ishin të shumëllojshme, si:

- Forume/Seminare rreth dhunës me bazë gjinore e pabarazive gjinore me nxënës e studentë;
- Pjesëmarrje në emisione televizive e radiofonike në Tiranë e rrethe;
- Fushatë dhurimi e koordinuar nga AWEN në bashkëpunim me Fashion Group Albania - në institucionet rezidenciale (strehëza për viktimat e dhunës dhe trafikimit, shtëpi fëmije). U dhuruan dyshekë, rroga për gra e fëmijë, këpucë, etj);
- Fushatë online 'Dalloje dhunën para se të nisë – 16 ditë, 16 shenja paralajmëruese';
- Shpërndarje materialesh ndërgjegjësuese, kontakt derë më derë në terren/ zona rurale;
- Evente artistike e sportive ndërgjegjësuese;
- Fushatë në shkolla nëpërmjet mbështetjes së miniprojekteve rreth barazisë gjinore;
- Aktivitete informuese e kapacitet-ngritëse me studentë rreth legjislacionit për dhunën;
- Takime e mbledhje me aktorë kyç në mbrojtje e mbështetje të të mbijetuarave të dhunës;
- Ndërgjegjësim nëpërmjet kinematografisë
- Performanca në rrugë (street activism) nga të rinjtë në qytete të ndryshme;
- Forume ndërgjegjësuese me vajza e gra;
- Tubime paqësore në rrethe;
- Ngritje kapacitetesh me vajza e gra vulnerabël.

KONTRIBUTE TË AWEN NË LOBIM DHE ADVOKACI

- Pjesëmarrje dhe kontribut në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore.
- AWEN është pjesë e grupit të punës në hartimin, finalizimin dhe hyrjen në fuqi të Planit të Veprimit për Rezolutën 1325;
- Kontribut në tryezat konsultuese lidhur me ligjet dhe politikat që adresojnë të drejtat e vajzave dhe grave në Shqipëri;
- Kontribute nga AWEN dhe anëtarët janë përfshirë në draftin përfundimtar të ligjit për Ndhimën Juridike të Garantuar dhe ndryshimet në Ligjin për Dhunën në Marrëdhëniet Familjare (dhe aktet nënligjore);
- Input-e zyrtare dhe rekomandime për komisionin e CEDAW, Delegacionin e KE, DG në Bruksel dhe Parlamentarë Evropianë, MShMS, Bashkitë, Komisionet Parlamentare, Ministrinë;
- Kontribute për Raportin e Delegacionit i BE-së në Shqipëri për vitin 2018, lidhur me të drejtat e vajzave e grave dhe përfaqësim i organizatave të grave në dëgjesat e KE-së në Bruksel;
- Pjesëmarrje dhe kontribut në dëgjesat/seancat e Kuvendit dhe Komisioneve Parlamentare rreth Dhunës ndaj Vajzave e Grave;
- Letra të Hapura drejtuar publikut të gjerë, mediave, hartuesve të politikave e ligj-zbatuesve.

TRE VJET PROGRAM I MBËSHTETUR NGA SIDA



- Mbrojtje e mbështetje për vajzat e gratë
- Zhvillim organizativ nëpërmjet ndërhyrjeve fuqizuese, shkëmbime eksperiencash, ngritje kapacitetesh.
- Advokaci dhe lobim për të drejtat e grave në nivel qendror e vendor.

NJË RRUGËTIM DINAMIK

AWEN falenderon të gjithë bashkëpunëtorët për kontributin e tyre në mbështetje të grave e vajzave në të gjithë Shqipërinë gjatë vitit 2018, si dhe shpreh mirënjohjen e thellë për Qeverinë Suedeze që vazhdon të besojë tek ne duke na mbështetur në vazhdimësi përgjatë 2019-2021! Falemnderit!